



SHOQATA
KOMBËTARE
E BASHKIVË
TË SHQIPËRISË



VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR TRAJNIME PËR 61 BASHKITË E SHQIPËRISË RAPORTI FINAL

30 MARS 2026
SHOQATA KOMBËTARE E
BASHKIVË TË SHQIPËRISË



Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Tabela e Përmbajtjes

Lista e Shkurtimeve	3
Hyrje	4
Metodologjia	5
I. Analiza e Kontekstit Vendor, Rajonal dhe Ndërkombëtar (2026–2030).....	6
1. Konteksti Vendor.....	6
2. Konteksti Rajonal (Ballkani Perëndimor).....	8
3. Konteksti Ndërkombëtar (BE, donatorë, Praktika Globale).....	9
4. Implikimet për Vlerësimin e Nevojave për Trajnim	10
II. Analizë Përmbledhëse e Pyetësorëve të Strukturuar.....	10
Përmbledhje Ekzekutive	10
1. Profili i të Anketuarve	11
2. Pjesëmarrja në Trajnime & Dobishmëria	12
3. Kapacitetet Aktuale & Nevojat për Trajnim.....	15
4. Preferencat e të Nxënit: Format, Kohëzgjatje, Metoda.....	17
5. Mbështetja Organizative & Pengesat.....	20
6. Prioritetet Tematike & Llojet e Mbështetjes.....	21
7. Aftësi Personale & Gatishmëria për Përfshirje	22
8. Konkluzione	23
III. Përmbledhje e Pyetësorëve me Fokus Grupet.....	24
1. Gjetjet Kryesore.....	24
2. Sugjerime	26
3. Përcaktimi i Moduleve të Trajnimit (Tema → Modul).....	26
IV. Rekomandime	27
Aneksi 1: Pyetësor mbi Vlerësimin e Nevojave për Trajnime për 61 Bashkitë për vitin 2026	29
Aneksi 2: Pyetësori dhe përgjigjet me fokus grupet nga Bashkitë.....	35
1. Bashkia MAT	35

2. Bashkia BERAT.....	38
3. Bashkia POGRADEC	41
4. Bashkia ELBASAN.....	43
5. Bashkia VLORË	45
Referencat	47

Lista e Shkurtimeve

ASP	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi European
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
NALAS	Shoqata e Autoriteteve Vendore të Europës Juglindore
NAMA	Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
PESTLE	Një mjet analitik që përdoret për të analizuar faktorët e jashtëm që ndikojnë një organizatë, një projekt ose një politikë. Emri vjen nga inicialet e gjashtë kategorive kryesore: Politik, Ekonomik, Social, Teknologjik, Ligjor dhe Mjedisor
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim)
TALGA	Akademia e Trajnimit e Vetëqeverisjes Vendore
TNA	Vlerësimi i Nevojave për Trajnime
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Hyrje

Vlerësimi i Nevojave për Trajnime (TNA) për Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (NAMA) përbën një proces themelor për forcimin e kapaciteteve institucionale të pushtetit vendor dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike vendore. Në një kontekst politik, institucional dhe socio-ekonomik që po transformohet me ritme të shpejta-përfshirë procesin e decentralizimit, integrimin evropian dhe dixhitalizimin e administratës-identifikimi i nevojave reale të trajnimit është kthyer në një parakusht për funksionim bashkëkohor dhe përputhje me standardet e Bashkimit Europian (BE). Për këtë arsye, TNA synon të analizojë në mënyrë të strukturuar kapacitetet ekzistuese të bashkive, boshllëqet në njohuri dhe aftësi, si dhe përputhshmërinë e këtyre kapaciteteve me objektivat strategjike të qeverisjes vendore dhe prioritetet kombëtare të zhvillimit.

Metodologjia mbi të cilën mbështetet ky vlerësim ndërtohet mbi tri nivele analitike plotësuese: (i) nivelin organizativ, që shqyrton lidhjen midis programeve të trajnimit dhe strategjive kombëtare e vendore; (ii) nivelin funksional, që analizon kërkesat teknike dhe profesionale të departamenteve bashkiake; dhe (iii) nivelin individual, që vlerëson kompetencat e punonjësve dhe diferencën midis aftësive të nevojshme dhe atyre aktuale. Këto tre nivele sigurojnë një qasje analitike gjithëpërfshirëse dhe mundësojnë krijimin e një harte të qartë të prioritetëve të trajnimit për të gjitha bashkitë anëtare të NAMA-s.

Për të garantuar saktësi metodologjike dhe rezultate të besueshme, vlerësimi mbështetet në një kombinim të metodave të mbledhjes së të dhënave. Pyetësi i strukturuar online synon të mbledhë informacion të standardizuar nga 61 bashkitë e vendit mbi aftësitë aktuale, sfidat dhe nevojat emergjente. Intervistat gjysmë të strukturuar me fokus-grupet shërbejnë si instrumente cilësore për të thelluar kuptimin e tematikave sektoriale dhe për të identifikuar kërkesa specifike sipas fushave të vetë Bashkisë. Po ashtu, analizimi i strategjive kombëtare, raporteve të performancës të bashkive, dokumenteve të organizatave ndërkombëtare dhe referencave rajonale plotëson bazën e evidencave mbi të cilën ndërtohet vlerësimi.

Procesi metodologjik është i strukturuar në disa hapa të qartë: përgatitja dhe planifikimi, mbledhja e të dhënave, analiza e boshllëqeve, prioritarizimi i nevojave dhe në fazën përfundimtare nxjerrja e rekomandimeve dhe hartimi i planit të trajnimit. Afatet kohore të përcaktuara garantojnë zbatimin e qëndrueshëm dhe sistematik të procesit, duke përfshirë periudhën e analizës së kontekstit, shpërndarjen e pyetësorëve, intervistat, përpunimin e të dhënave dhe finalizimin e raportit.

Në këtë mënyrë, TNA shërben si një instrument strategjik që jo vetëm identifikon nevojat për trajnim, por orienton edhe politikën zhvillimore të NAMA-s dhe bashkive anëtare, duke kontribuar në profesionalizimin e administratës vendore, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe forcimin e rolit të pushtetit vendor në kuadër të integritetit evropian. Ky dokument synon të krijojë një rrugë të qartë për ndërtimin e kapaciteteve, duke e vendosur NAMA-n dhe bashkitë në një pozicion të qëndrueshëm për të përballuar sfidat aktuale dhe të ardhshme të qeverisjes vendore.

Metodologjia

Metodologjia e vlerësimit të nevojave për trajnim (TNA) është ndërtuar mbi një qasje të kombinuar ku janë përdorur metoda cilësore dhe sasiore, duke siguruar verifikim, përfaqësim dhe analizë të thelluar të kapaciteteve reale të bashkive.

Procesi i vlerësimit u mbështet në një metodologji të kombinuar, me disa burime dhe forma verifikimi të të dhënave:

1. Pyetësorë të strukturuar tematikë

Pyetësori u shpërnda në **61 bashki** dhe u kthyen të plotësuar nga **56 bashki** që përfshin 165 të intervistuar.

Pyetësorët u shpërndanë nëpërmjet **forumeve sektoriale**:

- Forumi Social
- Forumi i Arsimit
- Forumi i Performancës
- Forumi i Transportit dhe Energjisë & Klimës
- Forumi i Financave
- Forumi i Burimeve Njerëzore

Këto forume përfaqësohen nga drejtorët e departamenteve specifike dhe secili grup ka rreth 61 anëtarë.

2. Pyetësorë me fokus grupe me 5 bashki përfaqësuese

Përveç pyetësorëve të strukturuar tematikë në vlerësimin e nevojave u përdor metoda e intervistave gjysmë-të-strukturuar. Procesi i mbledhjes së informacionit përmes pyetësorëve me fokus grupet përfshiu përfaqësues të nivelit të lartë nga 5 bashki dhe pati si qëllim:

- (1) Të konfirmonte gjetjet kryesore të pyetësorit të strukturuar të shpërndarë te 61 bashkitë.
- (2) Të siguronte informacion për temat me interes të lartë për bashkitë dhe
- (3) Të ndërtonte një bazë të qëndrueshme në drejtim të rritjes së kapaciteteve.

Qëllimi final ishte krijimi i një tabloje të qartë, të besueshme dhe përfaqësuese të situatës së kapaciteteve të bashkive shqiptare në raport me sfidat aktuale të qeverisjes vendore dhe detyrimet që burojnë nga procesi i integritetit evropian.

Intervistat janë realizuar me këto Bashki:

- Bashkia Mat
- Bashkia Berat
- Bashkia Pogradec

- Bashkia Elbasan
- Bashkia Vlorë

3. Përpunimi dhe Analiza e të Dhënave të Pyetësorëve

Pyetësi i strukturuar u ndërtua me 24 pyetje në formatin google form. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e strukturuar iu nënshtruan një procesi të detajuar kategorizimi dhe harmonizimi, me qëllim sigurimin e një baze të qëndrueshme analitike. Pas verifikimit të plotësisë dhe konsistencës së përgjigjeve të dhënat u përpunuan duke përdorur grafikë përmes google form, të cilat mundësuan analizimin shumëdimensionale të të dhënave. Përmes përpunimit të të dhënave është bërë e mundur:

- grupimi i të dhënave sipas temave, funksioneve, profileve të stafit dhe përfaqësimit ndërbashkiak;
- kalkulimin automatik të përqindjeve, shpërndarjeve dhe indikatorëve sintetikë;
- krahasimin horizontal (midis bashkive) dhe vertikal (midis forumeve sektoriale);
- gjenerimin e vizualizimeve të standardizuara për interpretim më të qartë dhe të matshëm.

Kjo metodologji e përpunimit ka garantuar që rezultatet të jenë të sakta, të matshme dhe lehtësisht të konvertueshme në gjetje analitike, të përdorshme për hartimin e rekomandimeve dhe përkthimin e nevojave të identifikuara në module trajnimi.

Intervistat gjysmë të strukturuar u zhvilluan ballë për ballë përmes platformës zoom (12–18 mars 2026) dhe shërbyen si mekanizëm verifikimi të gjetjeve të pyetësorëve si dhe mundësoi komunikim të drejtpërdrejtë dhe një mjedis të sigurt për pjesëmarrësit. Secila intervistë zgjati mesatarisht 30 minuta nga 45 të planifikuara dhe me pëlqimin e pjesëmarrësve, e gjithë intervista u regjistrua për qëllime analitike. Pas përfundimit të procesit të mbledhjes së të dhënave, regjistrimet audio u zbardhën në mënyrë të plotë. Zbardhja u krye manualisht duke garantuar ruajtjen e saktësisë së informacionit. Tekstet e zbardhura më pas u analizuan nëpërmjet metodës së analizës tematike me qëllim identifikimin e modeleve, çështjeve kryesore dhe interpretimeve të rëndësishme për studimin.

I. Analiza e Kontekstit Vendor, Rajonal dhe Ndërkombëtar (2026–2030)

1. Konteksti Vendor

1.1. Transformimet Strategjike të Qeverisjes Vendore në Shqipëri

Periudha 2026–2030 shënon një moment kritik për qeverisjen vendore në Shqipëri, të shtyrë nga dinamika të forta të brendshme dhe një afat ambicioz për anëtarësimin në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030. Sipas analizës PESTLE¹ 61 bashkitë e vendit gjenden në epiqendrën e zbatimit

¹ Political, Economic, Social, Technological, Legal, Environmental analysis for Albania's local governments.

të reformave, pasi janë përgjegjëse për zbatimin e deri në **70% të *acquis communautaire***. Ky rol i zgjeruar **kërkon kapacitete më të forta administrative, fiskale dhe teknike në nivel vendor**.

Megjithatë, realiteti institucional tregon boshllëqe të theksuara:

- mungesë harmonizimi midis ligjit 139/2015 dhe ligjeve sektoriale, me mbi 400 akte ende të pa-përditësuara²;
- funksione të paqartë midis nivelit qendror dhe atij vendor³, që prodhojnë mbivendosje apo boshllëqe funksionale, sidomos në mjedis, bujqësi, kulturë dhe strehim social;
- një sistem konsultimi qendror-vendor ende joefektiv, i cili diskuton draftet e politikave vetëm në fazën përfundimtare⁴.

Këto dinamika ndikojnë drejtpërdrejt në nevojat për trajnim, sidomos në:

- interpretimin e legjislacionit të Bashkimit Europian (BE),
- qartësimin e kompetencave,
- aftësimin në hartimin e opinioneve politike dhe pjesëmarrjen në dialogun shumë-nivelësh.

1.2. Sfidat Ekonomike dhe Fiskale të Bashkive

Konteksti vendor paraqet sfida të theksuara fiskale që kushtëzojnë seriozisht kapacitetin e bashkive për të kryer funksionet e tyre. Sipas studimit PESTLE⁵ :

- **Autonomia fiskale është ndër më të ulëtat në Europën Juglindore.**
- Të ardhurat nga burimet e veta janë minimale dhe bashkitë varen masivisht nga transfertat të pakushtëzuara.
- Mekanizmi i barazimit fiskal është “shumë i vogël” dhe nuk adreson diferencat e thella midis bashkive urbane dhe rurale.

Për më tepër, reforma e **taksës së pronës** në bazë të vlerës së tregut (2025–2029) do të kërkojë:

- standarde të reja për matjen e pronës,
- njohuri teknike mbi administrimin fiskal,
- përdorimin e sistemeve dixhitale të tatimit (sistemi i informacionit të menaxhimit financiar AFMIS).

1.3. Dinamikat Sociale, Demografike dhe Kapacitetet Njerëzore

Shqipëria po përjeton një **rënia demografike prej 17%** gjatë dekadës së fundit⁶. Ky realitet krijon presione të mëdha mbi bashkitë, sidomos ato rurale që përballen me:

- mungesë të fuqisë punëtore,
- emigrim të rinjve,

² Albanian Municipalities in 2035: Three Scenarios for the Future, page 3

³ European Commission, Albania 2024 Report, page 24, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8ecc3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

⁴ Albanian Municipalities in 2035: Three Scenarios for the Future, page 12

⁵ 2025 PESTLE (Political, Economic, Social, Technological, Legal, Environmental) analysis for Albania's local governments

⁶ Albanian Municipalities in 2035: Three Scenarios for the Future, page 2

- plakje të shpejtë të popullsisë,
- rritje të kostove të shërbimeve sociale pa rritur burimet financiare.

Kjo situatë kërkon rritjen e kapaciteteve bashkiake në:

- ✓ planifikimin social,
- ✓ ofrimin e shërbimeve për grupet vulnerabël,
- ✓ zhvillimin e politikave rinore,
- ✓ menaxhimin e shërbimeve të kujdesit afatgjatë.

1.4. Transformimi Dixhital dhe Qeverisja Inovative

Nisur nga analiza PESTLE, Shqipëria po zhvillon një axhendë agresive të dixhitalizimit, me mbi **1,240 shërbime online** përmes e-Albania⁷. Por sfidat mbeten të rëndësishme:

- hendek i madh urban–rural në përdorimin e teknologjisë,
- mungesë aftësish dixhitale në administratën vendore,
- mungesë kuadri ligjor mbi inteligjencën artificiale dhe mbrojtjen e të dhënave.

Këto krijojnë nevoja për trajnim në:

- ✓ sigurinë kibernetike,
- ✓ përdorimin e AI dhe sistemeve smart,
- ✓ administrimin e të dhënave,
- ✓ shërbime dixhitale për qytetarët.

2. Konteksti Rajonal (Ballkani Perëndimor)

2.1. Tendencat Rajonale të Decentralizimit dhe Financave Vendore

Sipas të dhënave rajonale të Rrjetit të Shoqatave të Autoriteteve Vendore të Europës Juglindore NALAS⁸:

- rajoni karakterizohet nga një trend ulje të autonomisë fiskale së qeverive vendore;
- transferta të pakushtëzuara dhe grantet e kushtëzuara dominojnë financimin vendor;
- investimet kapitale në Shqipëri janë pesë herë më të ulëta se mesatarja e BE-së⁹;
- modeli i financimit vendor në Shqipëri është ndër më kufizuesit në rajon.

NALAS, Këshilli i Koordinimit Rajonal (RCC), etj dhe donatorët rajonalë po promovojnë modelet e bashkëpunimit ndërbashkiak si zgjidhje për bashkitë me kapacitete të ulëta, shërbimet publike

⁷ PESTLE Analysis for Albania's Local Governments (2025-2030), page 9

⁸ Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Vendore të Europës Juglindore

⁹ Albanian Municipalities in 2035: Three Scenarios for the Future, page 4

në mënyrë rajonale (menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, emergjencat) dhe rritjen e profesionalizmit të administratës vendore.

Theks i veçantë rajonal vërehet tek:

- reformat fiskale,
- standardet e BE-së për ujësjellës-kanalizime,
- ekonomia qarkulluese,
- dixhitalizimi dhe AI në shërbimet publike.

Shqipëria është prapa mesatares së rajonit në shumë nga këto fusha, gjë që e bën trajnimin një kërkesë urgjente për: kuptimin e kapitujve të BE-së që prekin nivelin vendor, menaxhimin mjedisor dhe ekonomik sipas direktivave të BE-së, transpozimin e politikave rajonale në nivel bashkie.

3. Konteksti Ndërkombëtar (BE, donatorë, Praktika Globale)

3.1. Axhenda e BE-së si forca kryesore ndryshuese dhe roli i donatorëve

BE-ja mbetet ndikimi kryesor në zhvillimin vendor, me kërkesa të forta për:

- sundimin e ligjit,
- administratë profesionale vendore,
- prokurim publik sipas direktivave të BE-së,
- mjedis dhe ekonomi qarkulluese,
- transparencë dhe pjesëmarrje publike.

Raporti i Komisionit Evropian 2024 evidenton:

- nevojën për rritjen e kapaciteteve bashkiake në prokurim, menaxhim financiar dhe mbikëqyrje,
- probleme të vazhdueshme me të drejtat e pronësisë,
- boshllëqe në zbatimin e standarteve mjedisore.

Organizatat si: SDC (Zvicra), Delegacioni i BE-së, SIDA, GIZ, Banka Botërore, UN Eomen, UNDP, kanë konsoliduar një axhendë të përbashkët që përfshin:

- modernizimin e menaxhimit financiar vendor,
- dixhitalizimin e shërbimeve,
- barazinë gjinore,
- ekonominë qarkulluese,
- kapacitetet për fondet e BE-së.

Këto programe prodhojnë domosdoshmërinë që bashkitë të kenë kapacitete të qarta teknike për të absorbuar fonde, për të hartuar projekte dhe për të përdorur sisteme teknologjike moderne.

3.2. Tendencat Globale që Prekin Qeverisjen Vendore

Sipas analizave ndërkombëtare të përfshira në PESTLE, disa trende globale ndikojnë në bashkitë shqiptare:

- dixhitalizimi i shërbimeve publike,
- inteligjenca artificiale në menaxhimin urban,
- ngrohja globale dhe rritja e rreziqeve klimatike,
- urbanizimi i shpejtë,
- rritja e standardeve të transparencës publike.

4. Implikimet për Vlerësimin e Nevojave për Trajnim

Nga analiza e tre niveleve (vendor, rajonal, ndërkombëtar), del qartë se nevojat e trajnimit për Shoqatën Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (NAMA) dhe bashkitë anëtare përqendrohen në 5 fusha kritike:

1. Kapacitete të Integritit & Acquis: transpozim, konsultim, menaxhim projektsh BE.
2. Financat Vendore & Autonomia Fiskale: taksa vendore, menaxhim i pasurive, planifikim buxhetor.
3. Menaxhim i Shërbimeve Vendore dhe Infrastrukturës: ujësjellës/kanalizime, menaxhim mbetjesh, ekonomia qarkulluse.
4. Transformim Digjital & AI në Qeverisjen Lokale: e-government, siguri kibernetike, standardizim i të dhënave.
5. Burime Njerëzore & Qeverisja Demokratike: Burime Njerëzore moderne, barazi gjinore, përfshirje komunitare, menaxhim i ndryshimit.

II. Analizë Përmbledhëse e Pyetësorëve të Strukturuar

Përmbledhje Ekzekutive


Ky seksion paraqet gjetjet kryesore nga 165 përgjigje të mbledhura nga 56 bashki. Nga analiza e pyetësorëve rezulton se pjesa më e madhe e të intervistuarve janë gra, ndërsa profili i përvojës tregon një bazë solide nga pikëpamja institucionale. Pjesëmarrja në trajnim është kryesisht mesatare dhe dobishmëria e trajnimeve vlerësohet shumë e lartë. Kapacitetet në menaxhim strategjik dhe lidhshmëri rezultojnë mesatarisht të mira (mesatare **3.54/5**), me hapësirë të qartë për avancim. Prioriteti i trajnimeve është për specialistët e nivelit teknik dhe drejtuesit e mesëm; formati fizik/hibrid dhe modulet 2–3 ditore janë më të preferuarat; pengesa kryesore mbetet ngarkesa e punës dhe mungesa e buxhetit/politikave të qarta. Shoqata Kombëtare e Bashkive të

Shqipërisë (NAMA) vlerësohet pozitivisht në rolin që ka, ndikimin dhe cilësinë e shërbimeve. Në vijim jepen konkluzionet e pyetësorëve.


1. Profili i të Anketuarve

Shpërndarja sipas gjinisë tregon përfshirje të lartë të grave në përgjigjet e pyetësorit në nivelin 72%, ndërsa përvoja në vite sinjalizon një miks mes punonjësve me eksperiencë të gjatë dhe atyre më të rinj në administratë. Rreth 50.2% e personave që kanë mbi 7 vite eksperiencë kanë marrë trajnime të avancuara sikurse tregojnë grafikët më poshtë.


Gjinia



Vitet e përvojës në bashki




Nëse keni mbi 7 vite përvojë, a keni marrë ndonjë trajnim të avancuar gjatë kësaj periudhe?




2. Pjesëmarrja në Trajnime & Dobishmëria

Frekuenca më e shpeshtë e pjesëmarrjes në trajnime është 3–5 herë/vit, me një segment të konsiderueshëm që ndjek rrallë trajnime. Arsyet kryesore për pjesëmarrje të rrallë ose aspak lidhen me mungesën e informacionit, kufizimet financiare dhe mungesën e kohës. Megjithatë, kur zhvillohen trajnimet ato perceptohen si shumë të dobishme për punën.

Shpeshësia e pjesëmarrjes në trajnime profesional




Arsyet Kryesore të Mospjesëmarrje në Trajnime



Përsa i përket pjesëmarrjes në trajnime të organizuara nga NAMA rreth 52.7% kanë marrë pjesë në trajnime. Pjesa tjetër që nuk kanë marrë pjesë në trajnime kanë listuar dy arsye më kryesore: mosinformimi dhe mungesa e kohës për të marrë pjesë. Një pjesë më e vogël janë shprehur se kanë perceptuar se temat nuk kanë patur lidhje me punën e tyre.


Disa nga fushat e mbuluara në trajnimet janë ato që lidhen me menaxhim dhe lidërsip, teknologji dixhitale, financë dhe buxhetim lokal, shërbime publike, legjislacion dhe procedura administrative, prokurimet publike, komunikim me qytetarët etj.

A keni marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë ?




Rreth 53% e të intervistuarve vlerësojnë se trajnimet kanë qënë shumë të dobishme ndërsa 43% prej tyre vlerësojnë se trajnimet janë të dobishme.

Dobishmëria e Trajnimeve në Punë



Pyetjes se cilat mund të jenë arsyet që trajnimet të jenë pak të dobishme, të intervistuarit japin disa arsye si: nuk pati ndjekje pas trajnimit, kohëzgjajtja ishte e papërshtatshme, metodologjia nuk ishte praktike, përmbajtja nuk ishte e përshtatshme sikurse paraqitet në grafikun më poshtë.


Arsyet e Dobishmërisë së Ulët të Trajnimeve



3. Kapacitetet Aktuale & Nevojat për Trajnim

Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në disa fusha të tilla si: Menaxhim strategjik & lidership, Financë dhe Buxhetim, Teknologji dhe e-qeverisje, Shërbime Publike si ujësjellës, transport dhe pastrim, urbanistikë dhe planifikim territorial, Shërbime Sociale dhe Kulturë, Komunikim Publik dhe Transparencë, Menaxhim i Emergjencave dhe Krizave, tregon një mesatare solide 3 nga 5 maksimalja me potencial të qartë për ngritje drejt niveleve të larta (vlerësimi nga 1 në 5 ku 1 përfaqëson nivelin më të ulët dhe 5 nivelin më të lartë). Nevoja për trajnim vlerësohet për specialistët (niveli teknik) dhe drejtuesit e mesëm.

Kapacitetet e stafit të bashkisë në fushat e shërbimeve (vlerësimi në vlerë absolute nga 1 më e ulët te 5 më e larta)




Fushat prioritare për trajnim në vitin 2026 renditen fushat më kryesore të shërbimeve të Bashkisë të tilla si:

- menaxhimi i mbetjeve, ujitja dhe kullimi, shërbimet sociale, dixhitalizimi i shërbimeve vendore, arsimi parauniversitar;
- furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, energjia, klima, transporti urban dhe mobiliteti;
- menaxhimi i aseteve publike, kultura dhe trashëgimia kulturore;
- taksat dhe të ardhurat vendore, emergjencat civile.

Për fushat e zgjedhura të renditura më sipër kur pjesëmarrësit pyeten se cilat aftësi specifike mungojnë rreth 25.5% e të intervistuarve përgjigjen se mungojnë aftësi praktike, 52.7% përgjigjen se mungojnë tërësia e aftësive praktike, përdorimi i teknologjisë dhe njohuritë teorike, 18.2 % përgjigjen se mungojnë aftësitë e përdorimit të teknologjisë dhe 3.6% përgjigjen se mungojnë aftësitë teorike.


Për Fushat e zgjedhura, cilat aftësi specifike mungojnë?



Nivelet e stafit që kanë më shumë nevojë për trajnim sipas peshës janë:

1. Specialistët e nivelit teknik
2. Drejtuesit e mesëm
3. Drejtuesit e lartë
4. Staf mbështetës


Në cilat nivele të stafit mendoni se ka më shumë nevojë për trajnim?



Tematika e aftësitë specifike që mungojnë lidhen me:

- Menaxhim projektsh (52.7%)
- Njohuritë ligjore (24.2%)
- Lidership (12.7%)
- Komunikim (10.3%)


Cilat aftësi specifike mungojnë në këtë nivel?




4. Preferencat e të Nxënit: Format, Kohëzgjatje, Metoda

Formatet më të preferuara të të nxënit janë trajnimet fizike dhe ato hibride (kombinim fizik me online) ndërsa për pjesëmarrësit online, Zoom rezulton platforma më e përdorur. Kohëzgjatja optimale është 2–3 ditë dhe mënyra më e preferuar e të nxënit janë modulet e ndara. Metodologjikisht kërkohen ushtrime praktike dhe studime rastesh.

Cili format trajnimi preferoni?



Platformat e preferuara për pjesëmarrësit online



Kohëzgjatja e trajnimit

Më shumë se 1 javë


4.8%

1 javë

6.7%

1 ditë

11.5%




2-3 ditë

77.0%

Mënyra e preferuar e të nxënit

Trajnim i vazhdueshëm

38.8%




Module të ndara

61.2%

Lidhur me metodat e preferuara të mësimdhënies vlerësohen të jenë ushtrimet praktike, studime rastesh, vizita studimore, simulime dhe role play dhe ligjërata teorike.

Metodat e preferuar të mësimdhënies




5. Mbështetja Organizative & Pengesat

Mbështetja institucionale për trajnime perceptohet mesatarisht e mirë, por një pjesë e stafit raporton pak ose aspak mbështetje.

Fushat ku vlerësohen dobësi institucionale përfshijnë:

- Planifikim dhe koordinim
- Menaxhim performance
- Monitorim projektsh

Mbështetje institucionale për trajnime



Zgjidhjet e propozuara përfshijnë buxhet të dedikuar dhe politika të brendshme të qarta. Pengesat kryesore për zhvillim profesional lidhen me ngarkesën e punës, mungesën e mundësive për avancim dhe mungesën e mentorimit.

Nëse pak ose aspak, çfarë do të ndihmonte?

Motivim nga drejtuesit


15.8%

Politika e brendshme e qartë...

26.1%

Buxhet i dedikuar

58.2%



Pengesat për Zhvillim Profesional

Politika të paqarta institucionale

14.6%

Mungesë mentorimi


18.5%

Mungesë mundësish për avancim

23.5%

Ngarkesë e madhe pune

43.4%



6. Prioritetet Tematike & Llojet e Mbështetjes


Nevojat për trajnime përfshijnë projektet e financuara nga BE, rolin e bashkive në integrimin në BE, zbatimin e reformave në nivel vendor dhe monitorimin me indikatorë. Lloji më i kërkuar i mbështetjes është kombinimi “Trajnim + asistencë teknike”, së bashku me mbështetje për hartim planesh/rregulloresh/strategjish.

Nevojat për Trajnime

Rolin e bashkive në procesin e integrimit...
24.8%

Monitorimin e reformave me indikatorë
14.5%

Zbatimin e reformave në nivel vendor
20.0%



Lloji i Mbështetjes

Mentorim afat-mesëm


3.6%

Trajnim

10.3%

Plane/Rregullore/Strategji


27.9%



7. Aftësi Personale & Gatishmëria për Përfshirje


Për zhvillim individual, theksi vihet te vendimmarrja strategjike dhe zgjidhja e problemeve, komunikim dhe prezantim, menaxhimi i kohës dhe vendosja e prioriteteve. Shumica e bashkive janë të gatshme të kenë mbështetje shtesë në trajnime të personalizuar, ndërkohë që ka edhe gatishmëri për konsulencë individuale nga ekspertë, rrjete profesionale, burime dixhitale, shkëmbim eksperiencash.

Format e Mbështetjes Shtesë



Bashkitë janë të gatshme të marrin trajnime rajonale, përfshihen në grupe pune, ndajnë praktika të mira dhe të angazhohen në pilotime.

Gadishmëria e Bashkisë për Përfshirje



8. Konkluzione

Shpërndarja sipas gjinisë tregon përfshirje të lartë të grave në përgjigjet e pyetësorit në nivelin 72% me një miks përvojash, ku rreth gjysma e stafit me mbi 7 vite eksperiencë kanë ndjekur trajnime të avancuara. Frekuenca më e zakonshme e pjesëmarrjes në trajnime është 3–5 herë në vit, ndërsa pjesëmarrja e ulët lidhet kryesisht me mungesë informacioni dhe kohe. Trajnimet vlerësohen përgjithësisht si të dobishme, ndonëse përmenden disa probleme si metodologjia jo praktike dhe mungesa e ndjekjes pas trajnimit.

Nga trajnime të ofruara nga NAMA kanë përfituar 52.7% e të anketuarve, ndërsa të tjerët nuk kanë marrë pjesë kryesisht për shkak të mosinformimit. Kapacitetet e bashkive vlerësohen mesatarisht (3/5), me nevoja më të theksuara të specialistët të nivelit teknik dhe drejtuesit e mesëm. Kapacitetet e bashkisë janë vlerësuar për fushat: Menaxhim strategjik & lidërsip, Financë dhe Buxhetim, Teknologji dhe e-qeverisje, Shërbime Publike si ujësjellës, transport dhe pastrim, urbanistikë dhe planifikim territorial, Shërbime Sociale dhe Kulturë, Komunikim Publik dhe Transparencë, Menaxhim i Emergjencave dhe Krizave.

Aftësitë që mungojnë më shpesh janë ato praktike, teknologjike dhe menaxhimi i projekteve. Preferohen trajnimet fizike ose hibride (kombinim fizik me online), me fokus të ushtrimet praktike dhe rastet studimore. Mbështetja institucionale perceptohet e moderuar, me dobësi në planifikim, menaxhim performance dhe monitorim projektësh. Pengesat për zhvillim profesional lidhen me ngarkesën e punës, mungesën e avancimit dhe mentorimit.

Nevojat për trajnime përfshijnë projektet e BE-së, integrimin europian dhe zbatimin e reformave vendore. Bashkitë kërkojnë kombinimin “trajnime + asistencë teknike” dhe shprehin gatishmëri për trajnime rajonale, grupe pune dhe shkëmbim eksperiencash.

III. Përmbledhje e Pyetësorëve me Fokus Grupet

1. Gjetjet Kryesore

Bashkitë konfirmojnë se tre temat më të rëndësishme janë:

1. Menaxhimi i projekteve me Bashkimin Europian

- Nevojë e madhe për rritje kapacitetesh në shkrimin, zbatimin dhe raportimin e projekteve.
- Nevoja për njohje të thelluar me procedurat e prokurimit **PRAG**, legjislacionin e BE-së.
- Bashkitë i konsiderojnë projektet me BE si burim financiar kyç.

2. Monitorimi me indikatorë të performancës

- Bashkitë operojnë gjithnjë e më shumë në bazë indikatorësh.
- Nevojë për standardizim, harmonizim të të dhënave dhe një sistem unik raportimi.

3. Integrimi europian dhe përafrimi me praktikën e BE-së

- Perceptohet shpesh si proces qendror, jo vendor.
- Kërkohet rritje ndërgjegjësimit, përfshirje praktike dhe rol më aktiv i bashkive.

Kapacitetet njerëzore: kush ka hendekun më të madh?

Nga të gjitha bashkitë:

- **Specialistët** janë grupi me hendekun më të madh, sepse:
 - Ata mbajnë barrën e zbatimit të projekteve dhe janë të lidhur drejtpërdrejt me terrenin.
 - Mungojnë aftësitë në raportim teknik, GIS, të dhëna, planifikim, standarde BE.
- Drejtuesit e mesëm kanë gjithashtu boshllëqe, sidomos në:
 - Menaxhimin e proceseve sipas standartit europian
 - Standardizimin e procedurave
 - Planifikimin sektorial
 - Koordinimin institucional

Planifikimi territorial dhe GIS

- Të gjitha bashkitë identifikojnë mungesë të theksuar kapacitetesh në:
 - Analizën hapësinore
 - Hartat GIS
 - Menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore
 - Interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit
 - Koordinimin mes sektorëve
- Problematikat më të shpeshta:
 - Të dhënat e ASIG nuk janë gjithmonë të azhuruara.
 - Mungon informacioni historik i investimeve.
 - Ka një tendencë të humbjes së kapaciteteve njerëzore, të cilët largohen drejt sektorit privat.

Standardizimi i procedurave dhe menaxhimi i të dhënave

- Mungesa e dokumentacionit unik në shumë procese.
- Nevojë për modele të njëjta të administrimit të territorit, hapësirave publike dhe raportimit.
- Disa bashki theksojnë mungesën e një zyre të mirëfilltë të statistikave.

Mekanizmat e qëndrueshmërisë së kapaciteteve

Bashkitë kërkojnë:

- Programe trajnimi të vazhdueshme, jo sporadike.
- Platformë kombëtare unifikuese që të integrojnë trajnimet që ofrohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), Akademia e Trajnimit për Vetëqeverisjen Vendore (TALGA), donatorë, organizata të ndryshme etj.

- Modele të sukseshme për kalimin e njohurive renditen
 - ✓ Trajnimi i Trajnerëve
 - ✓ Shkëmbimi i praktikave mes bashkive
 - ✓ Binjakëzime me bashki të vendeve të BE-së
 - ✓ Rrjete profesionale sipas profileve
 - ✓ Projekte pilot brenda qarqeve

Shumë bashki theksojnë se projektet afatshkurtra mbartin rrezikun e humbjes së ekspertizës kur projektet përfundojnë.

2. Sugjerime

Për strukturat qendrore dhe institucionet e trajnimit

- Krijimi i një platforme kombëtare unike për trajnime, me kalendar të përbashkët për trajnimet që ofrohen nga ASPA, TALGA, BE, OJQ etj.
- Hartimi i moduleve standarde, të vlefshme për të gjitha bashkitë.
- Ndërtimi i një sistemi kombëtar të menaxhimit të njohurive.

Për bashkitë

- Investim në kapacitete GIS, statistikë, monitorim dhe raportim.
- Krijimi i strukturave të brendshme të qëndrueshme për të dhëna dhe integrim.
- Forcimi i nivelit teknik (specialistëve), por edhe atij drejtues.
- Shmangia e mbivendosjes së trajnimeve – nevojitet koordinim i centralizuar.

Për procesin e integritimit në BE

- Përfshirje më e thellë e bashkive në kapitujt e BE-së.
- Përafrim i detyrave të kapitujve në veprimtari konkrete për bashkitë.
- Rritje e komunikimit ndërmjet strukturave për integrimin dhe drejtorive të linjës.

Për projektet me BE

- Trajnime të detajuara dhe të përsëritura për procedurat e prokurimit PRAG, raportim, planifikim financiar.
- Mekanizma mbështetës të specializuar (asistence teknike në kuadër të TALGA).
- Shkëmbim praktik me bashki me përvojë të suksesshme.

Qëndrueshmëria afatgjatë

- Skema incentivash për të ruajtur ekspertizën në bashki.
- Modele mentorimi dhe trajnerësh të brendshëm.
- Projekte pilot me fokus në sektorë prioritarë të secilit qark.

3. Përcaktimi i Moduleve të Trajnimit (Tema → Modul)

Çdo nevojë e identifikuar do të shndërrohet në një modul konkret trajnimi, p.sh.:

Menaxhim i projekteve BE → Modul 1
PRAG & Prokurime BE → Modul 2
GIS & analiza hapësinore → Modul 3
Monitorim me bazë indikatorësh → Modul 4
Statistikë & menaxhim i të dhënave → Modul 5
Planifikim territorial & interpretim legjislativ → Modul 6
E-government & siguri kibernetike → Modul 7
Lidership & menaxhim → Modul 8
Shërbimet ujësjellës, kanalizime, ekonomia qarkulluese → Modul 9

Ky transformim siguron lidhjen direkte midis gjetjeve dhe ndërhyrjeve të trajnimit.

Përcaktimi i Metodave të Trajnimit

Plani i trajnimit do të përdorë kombinim metodash:

Trajnime fizike në klasë: Për temat që kërkojnë punë teknike praktike (GIS, PRAG, indikatorë).

Trajnime online / hibride: Zoom, Moodle, Teams — për uljen e kostove dhe rritjen e frekuencës.

Mentorim

- Për stafet e reja dhe drejtuesit e mesëm.
- I përshtatshëm për ciklin e projekteve të BE-së.

Shkëmbim praktikash (peer learning): Bashki të mëdha udhëheqin seminare për bashkitë me kapacitete më të ulëta.

Studime rasti/simulim për procedurat PRAG, hartimit të buxhetit dhe planifikimit territorial.

IV. Rekomandime

1. Program vjetor zhvillimi profesional, i ndërtuar në module 2–3-ditore, të ofruara në format fizik dhe/ose hibrid (kombinim i trajnimit fizik me online). Programi të fokusohet tek studimet e

rasteve dhe ushtrimet praktike, me seksione të dedikuara sipas niveleve të ndryshme të stafit për të siguruar përshtatje me rolet dhe përgjegjësitë.

2. Përmirësimi i informimit dhe aksesit në trajnimet. Bashkitë duhet të krijojnë një sistem të rregullt komunikimi për njoftimet e trajnimeve, me kalendar vjetor dhe njoftime të qarta për stafin. Gjithashtu rekomandohet të krijohet një platformë kombëtare unike për trajnime, me kalendar të përbashkët për trajnimet që ofrohen nga ASPA, TALGA, BE, OJQ dhe hartimi i moduleve standarde, të vlefshme për të gjitha bashkitë.

3. Hartimi i një moduli të dedikuar për projektet BE, që përfshin trajnim të specializuar mbi ciklin e projektit të BE-së, shkrimin e projekteve, menaxhimin financiar, raportimin, procedurat e prokurimit, si edhe një komponent të strukturuar mentorimi për forcimin e kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet.

4. Hartimi i një politike të brendshme të trajnimeve, e shoqëruar me buxhet të dedikuar, kalendar vjetor të aktiviteteve, kritere të qarta për përzgjedhjen e pjesëmarrësve, procedura certifikimi dhe Indikatorë Kyç të Performancës (KPI) për matjen e impaktit të programeve. Trajnimet duhet të dedikohen kryesisht për nivelin teknik (specialistët) dhe drejtues të mesëm pa lënë pas dore edhe nivelin e lartë drejtues.

5. Program mentorimi dhe krijimi i grupeve praktike që të përfshijë materiale dhe mësim të shkurtër online, të cilat ofrojnë fleksibilitet dhe mundësi të vazhdueshme për zhvillim profesional.

6. Trajnime të rregullta dhe praktike që t'i pajisin punonjësit e qeverisjes lokale me aftësi në teknologji digjitale, siguri kibernetike dhe përdorim të AI, të fokusuara në: monitorimin inteligjent të infrastrukturës, praktikat moderne të menaxhimit të mbetjeve, modelet e ekonomisë qarkulluese dhe përdorimin e teknologjive digjitale për planifikimin dhe menaxhimin territorial.

7. Kombinimi i trajnimeve me asistencë teknike dhe shkëmbim praktikash
Për të rritur efektin afatgjatë, trajnimet duhet të shoqërohen me asistencë teknike. Për më tepër, bashkitë duhet të nxisin trajnime rajonale dhe shkëmbime praktikash për të mësuar nga eksperiencia e njëra-tjetrës.

8. Për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë rekomandohet:

- Skema incentivash për të ruajtur ekspertizën në bashki.
- Modele mentorimi dhe trajnerësh të brendshëm.
- Projekte pilot me fokus në sektorë prioritarë të secilit qark.

Aneksi 1: Pyetësor mbi Vlerësimin e Nevojave për Trajnime për 61 Bashkitë për vitin 2026

I/E Nderuar

Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (NAMA)

Pyetësor për Bashkitë – TNA 2026 & Strategjia e Mbledhjes së Fondeve / Modeli i ri i Anëtarësimit

Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (NAMA), në përmbushje të misionit të saj për forcimin e kapaciteteve të qeverisjes vendore dhe duke u mbështetur në Planin Strategjik të NAMA 2026–2030, po zhvillon Vlerësimin e Nevojave për Trajnime (Training Needs Assessment – TNA) për vitin 2026, si dhe konsultimin për Strategjinë e Mbledhjes së Fondeve dhe Modelin e ri të Anëtarësimit.

Ky pyetësor duhet të plotësohet një herë për çdo funksion nga një përfaqësues i autorizuar i bashkisë. Përgjigjet duhet të pasqyrojnë vlerësimin institucional të nevojave të bashkisë, jo vetëm përvojën personale të individit që e plotëson.

Të dhënat e mbledhura do të përdoren për:

- Hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve të NAMA-s për vitin 2026;
- Përshtatjen e përmbajtjes së trajnimeve me nevojat reale të bashkive;
- Planifikimin afatmesëm të zhvillimit të kapaciteteve;
- Përgatitjen e Strategjisë së Mbledhjes së Fondeve dhe Modelit të ri të Anëtarësimit.

Ju lutemi të dërgoni përgjigjet tuaja **deri më 6 Shkurt 2026**.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Seksioni A: Informacion i përgjithshëm

1. Bashkia: _____
2. Emri/Mbiemri _____
3. Departamenti/Spektori: _____
4. Pozicioni i punës: _____
5. Gjinia: F ___ M
6. Vitet e përvojës në bashki:
 - Më pak se 1 vit
 - 1–3 vite
 - 4–7 vite
 - Mbi 7 vite
 - **Nënpyetje:** Nëse keni mbi 7 vite përvojë, a keni marrë ndonjë trajnim të avancuar gjatë kësaj periudhe?
 - Po
 - Jo
7. Sa shpesh merrni pjesë në trajnime profesionale?

- Asnjëherë
- Rrallë (1–2 herë në vit)
- Mesatarisht (3–5 herë në vit)
- Shpesh (më shumë se 5 herë në vit)
- **Nënpyetje:** Nëse rrallë ose asnjëherë, cili është shkaku kryesor?
 - Mungesë kohe
 - Mungesë informacioni
 - Mungesë motivimi
 - Burime financiare të kufizuara
 - Tjetër: _____

Seksioni B: Përvoja e mëparshme me trajnime

8. A keni marrë pjesë në trajnime të organizuara nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë ?
- Po
 - Jo
 - **Nënpyetje:** Nëse jo, cili është shkaku?
 - Nuk kam qenë i informuar
 - Nuk kam pasur kohë
 - Nuk kam parë lidhje me punën time
 - Tjetër: _____
9. Nëse keni marrë pjesë në trajnime të organizuara nga institucione të tjera cilat fusha kanë qenë të mbuluara? (zgjidhni të gjitha që aplikohen)
- Menaxhim dhe lidhësi
 - Financë dhe buxhetim lokal
 - Teknologji digjitale
 - Shërbime publike
 - Investimet kapitale
 - Taksat Vendore
 - Komunikim me qytetarët
 - Legjislacion dhe procedura administrative
 - Tjetër: _____
10. Sa të dobishme kanë qenë këto trajnime për punën tuaj?
- Shumë të dobishme
 - Mjaft të dobishme
 - Pak të dobishme
 - Jo të dobishme
 - **Nënpyetje:** Nëse pak ose jo të dobishme, pse?
 - Përmbajtja nuk ishte e përshtatshme
 - Metodologjia nuk ishte praktike
 - Kohëzgjatja ishte e papërshtatshme

- Nuk pati ndjekje pas trajnimit

Seksioni C: Nevoja aktuale për trajnim

11. Si do ta vlerësonit nivelin aktual të kapaciteteve të stafit të bashkisë në fushat e mëposhtme? (**vendosni numra në secilën kuti nga 1 deri te 8 ku 1 përfaqëson nivelin më të ulët dhe 8 përfaqëson nivelin më të lartë**).

- Menaxhim strategjik dhe lidership
- Financë dhe buxhetim
- Teknologji digjitale dhe e-qeverisje
- Shërbime publike (ujësjellës, pastrim, transport)
- Urbanistikë dhe planifikim territorial
- Shërbime sociale dhe kulturë
- Komunikim publik dhe transparencë
- Menaxhimi i emergjencave dhe krizave

12. Cilat fusha janë prioritarë për trajnim për vitin 2026 (Ju lutem zgjidhni **maksimumi 3 fusha prioritare**)

- Ujitja dhe kullimi
- Pyjet dhe kullotat
- Menaxhimi i mbetjeve
- Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet
- Taksat dhe të ardhurat vendore
- Menaxhimi i aseteve publike
- Arsimi Parauniversitar
- Emergjencat civile
- Mjedisi dhe pyjet
- Shërbimet sociale dhe mbrojtja e grupeve vulnerabël
- Barazia gjinore dhe buxhetimi gjinor
- Energjia, klima dhe efienca energjetike
- Transporti urban dhe mobiliteti
- Kultura dhe trashëgimia kulturore
- Digjitalizimi i shërbimeve vendore
- Tjetër: _____

Nënpyetje: Për Fushat e zgjedhura, cilat aftësi specifike mungojnë?

- Njohuri teorike
- Aftësi praktike
- Përdorimi i teknologjisë
- Të gjitha së bashku
- Tjetër _____

13. Në cilat nivele të stafit mendoni se ka më shumë nevojë për trajnim?

- Drejtuesit e lartë
- Drejtuesit e mesëm
- Specialistët teknikë
- Stafi mbështetës
- **Nënpyetje:** Cilat aftësi specifike mungojnë në këtë nivel?
 - Lidership
 - Komunikim
 - Menaxhim projektsh
 - Njohuri ligjore

Seksioni D: Preferenca për trajnim

14. Cili format trajnimi preferoni?

- Online
- Fizik (në klasë)
- Kombinim
- **Nënpyetje:** Nëse online, cilat platforma preferoni?
 - Zoom
 - Microsoft Teams
 - Google Meet
 - Tjetër: _____

15. Sa duhet të zgjasë një trajnim për të qenë efektiv?

- 1 ditë
- 2–3 ditë
- 1 javë
- Më shumë se 1 javë
- **Nënpyetje:** Preferoni trajnime të ndara në module apo të vazhdueshme?
 - Module të ndara
 - Trajnim i vazhdueshëm

16. Cilat metoda mësimdhënieje preferoni?

- Ligjërata teorike
- Ushtrime praktike
- Studime rastesh
- Simulime dhe role-play
- Vizita studimore

Seksioni E: Pengesat dhe mbështetja

17. Në cilat fusha mendoni se bashkia juaj ka dobësi institucionale?

- Planifikim dhe koordinim
- Menaxhim performance dhe raportim
- Zbatim legjislacioni
- Monitorim projektsh
- Konsultim publik dhe transparencë
- Bashkëpunim ndërbashkiak

18. Sa mbështetje institucionale ekziston për trajnime?

- Shumë mbështetje
- Disa herë mbështetje
- Pak mbështetje
- Aspak mbështetje
- **Nënpyetje:** Nëse pak ose aspak, çfarë do të ndihmonte?
 - Politika e brendshme e qartë për trajnime
 - Buxhet i dedikuar
 - Motivim nga drejtuesit

19. Cilat janë pengesat kryesore që ju kufizojnë në zhvillimin profesional?

- Mungesë mundësish për avancim në punë
- Mungesë mentorimi ose udhëzimi
- Politika të paqarta institucionale
- Ngarkesë e madhe pune që lë pak hapësirë për zhvillim
- Tjetër: _____

Seksioni F: Sugjerime

20. A ka nevojë bashkia juaj për trajnim mbi:

- Rolin e bashkive në procesin e integrimit në BE
- Zbatimin e reformave në nivel vendor
- Monitorimin e reformave dhe përdorimin e indikatorëve
- Projekte të financuara nga BE

21. Çfarë lloj mbështetjeje ju nevojitet më shumë?

- Trajnim

- Trajnim + asistencë teknike
- Mentorim afatmesëm
- Mbështetje për hartim planesh, rregulloresh, strategjish

22. Cilat aftësi personale do të dëshironit të zhvilloni përmes trajnimeve të ardhshme?"

- Aftësi komunikimi dhe prezantimi
- Aftësi udhëheqëse dhe menaxhimi ekipi
- Aftësi për zgjidhjen e problemeve
- Aftësi për vendimmarrje strategjike
- Aftësi për menaxhimin e kohës dhe prioriteteve
- Tjetër: _____

Nënpyetje “Nëse do të kishit mbështetje shtesë, në cilën formë do ta preferonit?”

- Konsulencë individuale nga ekspertë
- Trajnime të personalizuar sipas nevojave
- Rrjete profesionale
- Burime digjitale (platforma online)
- Tjetër: _____

Seksioni G: Gadishmëria për bashkëpunim

23. A është bashkia juaj e gatshme të:

- Marrë pjesë në trajnime rajonale
- Ndajë praktika të mira
- Marrë pjesë në grupe pune
- Angazhohet në pilotime

24. Nëse keni komente shtesë ju lutem shkruani më poshtë:

Aneksi 2: Pyetësi dhe përgjigjet me fokus grupet nga Bashkitë

1. Bashkia MAT

Intervistuesi: Evis Gjebrea, ekspert për Vlerësimin e Nevojave për Trajnime

Facilituesi: Elisa Nikaj, Koordinator projektsh pranë Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë

I intervistuari: Z. Alison Reçi / Sekretar i Përgjithshëm pranë Bashkisë Mat

Data: 12 Mars, 2026

A) Pyetje për të konfirmuar gjetjet (5–10 minuta)

1. Nga temat e listuara si prioritare (projekte BE; roli në integrim & zbatimin e reformave; monitorimi me indikatorë), cilat dy janë realisht më kritike sot për bashkinë tuaj? Pse?
2. Grupet ku duhet fokusuar: A vijojnë specialistët teknikë dhe drejtuesit e mesëm të jenë grupet që kanë hendekun më të madh të aftësive? Në cilat detyra specifike?

Përgjigje

1. Projektet me Bashkimin Europian janë më prioritaret sot për sot pasi sjellin financime dhe kanë impakt më të madh. Meqënëse zhvillohet kjo bisedë lidhur me nevojat për trajnime do të sugjeroja që zhvillimi i trajnimeve të bëhet në mënyrë të unifikuar pra trajnimet që ofrohen nga Akademia e Trajnimit për Vetëqeverisjen Vendore (TALGA) apo Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), të mos mbivendosen apo të përsëriten sepse ende kryhen trajnime sesi të shkruhet një projekt ndërkohë që projektet janë fituar, zbatohen dhe tashmë është kaluar në një fazë tjetër.
2. Nuk ka hendek ndërmjet nivelit nga specialist deri te drejtori. Specialisti merret me anën burokratike, ndërsa drejtori nxjerr problematikat dhe i adreson. Nevojat që dalin janë kapacitetet apo specialistë për hartimin dhe menaxhimin e tyre. Një formë Organizimi mund të jetë që Agjencia Shtetërore e Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC) të ofrojë ekspertë për projektet e BE-së. Bashkia Mat ka eksperiencë sepse ka menaxhuar projekte në shumën 3.4 milionë Euro. Bashkia Mat ka bashkëpunuar me SASPAC në këtë drejtim dhe po ashtu janë organizuar seminare nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Po kështu është krijuar Akademia e Trajnimit e Vetëqeverisjes Vendore që ka si detyrë të ofrojë seminare edhe për projektet e BE-së.

Grupet ku duhet të fokusohet në vazhdimësi rritja e kapaciteteve janë nga niveli i specialistit deri te drejtori.

B) Pyetje për temat me interes të lartë (20–25 minuta)

1. Në cilat procese të administrimit vendor (p.sh., planifikim, raportim, standardizim procedurash, menaxhim të të dhënave) e shihni më të mundshëm kontributin konkret të bashkisë suaj në procesin e integritimit në BE, dhe cilat kapacitete shtesë ju nevojiten për t'i përmbushur këto kërkesa në përputhje me praktikatat europiane?

2. Planifikimi territorial është kthyer në një çështje të rëndësishme për Bashkitë. “Cilat kapacitete teknike dhe institucionale i mungojnë bashkisë suaj për të kryer në mënyrë të efektshme procesin e planifikimit territorial—përfshirë analizën hapësinore, menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore, interpretimin e legjislacionit dhe koordinimin me aktorë të tjerë—dhe çfarë mbështetjeje do t'ju duhej për t'i forcuar këto kapacitete në praktikë?”

Përgjigje

1. Në bashkinë Mat ka një strukturë të integritimit të ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave si në cdo bashki me 3 persona një përgjegjës dhe 2 specialistë. Ka rreth 1 vit e gjysëm që është ngritur një strukturë e brendshme dhe është caktuar një person me ndjekjen e performancës së të dhënave, pasi mungonte zyra e statistikave dhe kjo konsiderohet si një strukturë e unifikuar. Nuk është ende e konsoliduar dhe nuk ka një informacion të standardizuar psh një tabelë të standardizuar për të gjitha Bashkitë. Gjithsesi ky është një hap pozitiv.

Psh për menaxhimin e territorit nuk ka një procedurë të standardizuar nëse prona është tjetërsuar dhe është e nevojshme ndarja e informacionit nëse është zhvilluar një pronë pasi edhe brenda vetë strukturave të Bashkisë nuk ndahet informacioni.

2. Mbështetja nga ASIG është e nevojshme për shkak se kanë ekspertizë, kanë mjetet e duhura. Ka ecuri në këtë drejtim psh. adresari e ka lehtësuar procesin në drejtim të dhënies së informacionit për hapësirat, objektet, infrastruktura, por nuk merret i gjithë informacioni sepse nuk ka informacion historik për investimet e mëparshme, për rrjetet Ujësjellës Kanalizime, të rrjetit të telekomit etj. Si rezultat nuk merret informacioni i plotë që duhet për planifikimin.

C) Pyetje për qëndrueshmërinë e rritjes së kapaciteteve të Bashkive (10–15 minuta)

1. Cilat mekanizma ose modele zhvillimi (p.sh., programe të qëndrueshme trajnimi, sisteme të brendshme të menaxhimit të njohurive, rrjete ndërbashkiake të të mësuarit apo asistencë teknike e vazhdueshme) mendoni se duhet të ndërtojë bashkia juaj në vitet e ardhshme për të siguruar rritje të qëndrueshme të kapaciteteve dhe për të përmbushur standardet moderne të qeverisjes vendore?”

2. Sa të gatshëm jeni të ndani praktika të mira ose të përfshiheni në pilotime apo grupe pune që lidhen me tematikat ku bashkia juaj ka nevojë të forcohet?”

Përgjigje

1. Bashkia MAT ka eksperiencë me trajnimin e trajnerëve, të cilët më pas e kanë ndarë njohurinë me të tjerët. Problemi që haset lidhet me projektet që përfshijnë trajnimet pasi në momentin kur përfundon projekti ikën dhe ekspertiza e ndërtuar.

Ka patur experiencë në ndarjen e eksperiencave me Bashkitë e tjera. Psh projektet me financim të huaj nëse një bashki tjetër është në një fazë më të avancuar kemi kërkuar informacion sesi e kanë zbatuar projektin. Mendoj se trajnimi i trajnerëve dhe ndarja e eksperiencave me Bashki të tjera rezulton më i efektshëm.

Shkëmbimin e eksperiencave të tjera me Bashkitë e kemi të institucionalizuar duke lidhur marrëveshje në fushat e mbrojtjes civile (mjedisin, pyjet, zjarret) me 5 Bashki kufitare me Bashkinë Mat, ndërsa në fushën e bashkëpunimit për projekte me financim të huaj bashkëpunimi është nëpërmjet kontakteve.

Bashkia Mat është e gatshme që të krijojë bashkëpunime me Bashkitë e tjera. Në kuadër të TALGA do të ketë një platformë për menaxhimin e njohurive.

2. Bashkia BERAT

Intervistuesi: Evis Gjebrea, ekspert për Vlerësimin e Nevojave për Trajnime

Facilituesi: Elisa Nikaj, Koordinator projektsh pranë Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë

I intervistuari: Zj. Etleva Dhima / N/Kryetare e Bashkisë Berat

Data: 17 Mars, 2026

A) Pyetje për të konfirmuar gjetjet (5–10 minuta)

Nga temat e listuara si prioritare (projekte BE; roli në integrim & zbatimin e reformave; monitorimi me indikatorë), cilat dy janë realisht më kritike sot për bashkinë tuaj? Pse?

Grupet ku duhet fokusuar: A vijojnë specialistët teknikë dhe drejtuesit e mesëm të jenë grupet që kanë hendekun më të madh të aftësive? Në cilat detyra specifike?

Përgjigje

1. Bashkitë në 3 apo 4 vitet e fundit e kanë kuptuar rolin e Bashkimit Europian, integrimin, jo vetëm për faktin e përafrimit të legjislacionit dhe përafrimit të shërbimeve, por duke patur parasysh edhe mundësitë e pafundme që ekzistojnë me projektet e Bashkimit Europian në lidhje me financimin e projekteve për Bashkitë. Nisur nga eksperiencia e mëparshme prej 15 vitesh me projekte janë rritur kapacitetet duke filluar nga projektet e vogla deri te projektet e infrastrukturës në programe të ndryshme të asistencës me Bashkimin Europian dhe ja kemi dalë duke mbuluar boshllëqet në financim nga buxheti i bashkisë. Sipas legjislacionit të ri në kuadër të programeve kufitare Bashkitë mund të aplikojnë në projekte ndërkuftare. Gjithashtu ekzistojnë programe nga Bashkimi Europian ku bashkitë mund të përfitojnë projekte për shërbimet sociale, projekte me të rinjtë, apo projektet për personat me aftësi ndryshe etj.

Aspekt tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me monitorimin e indikatorëve. Në 2 vitet e fundit operohet mbi bazë indikatorësh. Projekti Bashki të Forta ka përfshirë edhe Bashkinë Berat ku bashkitë vlerësohen sipas performancës në bazë të disa indikatorëve që përfshin gjithë gamën e shërbimeve për shërbimet si mbrojtja civile, ujësjellës kanalizime, mbetjet, arsimit, shëndeti publik. Monitorimi mbi bazë indikatorësh është më e rëndësishmja sepse duke vlerësuar indikatorët kryhet një analizë e punës së brendshme të Bashkisë për të parë ku janë pikat e dobëta, forta dhe ku duhet të fokusohen programet e zhvillimit në vitet në vijim.

Nga ana tjetër projekte me Bashkimin Europian janë të rëndësishme. Mendoj se nëse për projektet e BE-së do të fokusoheshim te thithja e fondeve dhe zbatimin e këtyre projekteve të gjitha kapacitetet e drejtorive të Bashkisë do të rriteshin duke filluar nga drejtoria e projekteve që merret me shkrimin e tyre, drejtoria e prokurimit që merret me përgatitjen e dokumentacionit për prokurime, drejtoria e financës dhe drejtoritë që kanë të bëjnë me zbatimin sipas sektorëve. Ky është një ushtrim shumë i mirë për Bashkinë sepse na përafrohet de juro dhe de facto me Bashkimin

European duke e prekur atë më nga afër duke parë nga afër edhe përafrimin e legjislacionit, përafrimin sesi raportojmë pra bëhemi më afër me raportimin dhe zbatimin e projekteve të Bashkimit European.

2. Do të dëshiroja ta shtrija gamën edhe te niveli i ulët. Patjetër që niveli i mesëm dhe i lartë janë të rëndësishëm për tu përfshirë në rritje kapacitetesh në trajnime, por ata që punojnë direkt me projektet janë niveli i ulët pasi niveli i mesëm dhe i ulët merren me zbatimin e projekteve. Niveli ulët është akoma më i rëndësishëm.

Nga eksperiencia jonë nevojat janë në drejtim të përgatitjes së projekteve, në drejtim të raportimit, por patjetër në zbatim sidomos në fushën e prokurimeve se kemi të bëjmë me përafrimin e legjislacionit ku në kuadër të projekteve me BE zbatohet PRAG që është korniza ligjore dhe në këtë fushë është e nevojshme rritja e kapaciteteve. Kjo pasi specialistët tanë që merren me projektet kanë të nevojshme rregullat e prokurimit, shkruarjen e projekteve dhe për zbatimin e projekteve pasi thirrjet e projekteve me BE kanë specifikën e vet.

B) Pyetje për temat me interes të lartë (20–25 minuta)

1. Në cilat procese të administrimit vendor (p.sh., planifikim, raportim, standardizim procedurash, menaxhim të të dhënave) e shihni më të mundshëm kontributin konkret të bashkisë suaj në procesin e integritimit në BE, dhe cilat kapacitete shtesë ju nevojiten për t'i përmbushur këto kërkesa në përputhje me praktikat europiane?

2. Planifikimi territorial është kthyer në një çështje të rëndësishme për Bashkitë. “Cilat kapacitete teknike dhe institucionale i mungojnë bashkisë suaj për të kryer në mënyrë të efektshme procesin e planifikimit territorial—përfshirë analizën hapësinore, menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore, interpretimin e legjislacionit dhe koordinimin me aktorë të tjerë—dhe çfarë mbështetjeje do t'ju duhej për t'i forcuar këto kapacitete në praktikë?”

Përgjigje

1. Bashkia Berat ka patur eksperiencë të mirë në drejtim të planifikimit, raportimit dhe zbatimit me projektet e BE-së dhe me donatorë të tjerë dhe mund të japim kontributin duke patur eksperiencë të mirë. Nga ana tjetër kapacitetet shtesë që kërkohen kanë të bëjnë me kapacitetet që për menaxhimin financiar dhe menaxhimin ligjor të projekteve të BE-së. Pra pavarësisht që ka patur eksperiencë të mirë përsëri rritja e kapaciteteve është e nevojshme sepse edhe legjislacioni i BE-së azhurnohet edhe kriteret e aplikimit azhurnohen prandaj rritja e kapaciteteve është e nevojshme.

2. Në fushën e planifikimit urban duke patur parasysh investimet që kërkohen të realizohen dhe ka një specifikë si bashki sepse ka disa zona të territorit që janë zona të mbrojtura nga UNESCO pra ka një legjislacion që i referohet ligjit për trashëgiminë kulturore, por edhe rregulloret që kanë të bëjnë me trashëgiminë botërore të UNESCO do ishte e nevojshme analiza e të dhënave të territorit që kanë të bëjnë me sistemin gjeohapësinor. Kjo pasi specialistët që kemi patur në këtë fushë janë

larguar duke u përthithur nga sektori privat. Në kuadër të legjislacionit të ri që ka të bëjë me hapësirat publike do të kërkohet azhornimi i të gjithë territorit tonë duke krijuar një hartë në sistemin GIS që do të jetë shumë e rëndësishme për caktimin e hapësirave publike të parkimit, për parqet rekreative etj. Në këtë rast do të jetë e nevojshme asistenca teknike për specialistët tanë të planifikimit urban. Pra asistenca për analizën e planifikimit gjeohapësinor dhe për hapësirat publike.

C) Pyetje për qëndrueshmërinë e rritjes së kapaciteteve të Bashkive (10–15 minuta)

1. Cilat mekanizma ose modele zhvillimi (p.sh., programe të qëndrueshme trajnimi, sisteme të brendshme të menaxhimit të njohurive, rrjete ndërbashkiake të të mësuarit apo asistencë teknike e vazhdueshme) mendoni se duhet të ndërtojë bashkia juaj në vitet e ardhshme për të siguruar rritje të qëndrueshme të kapaciteteve dhe për të përmbushur standardet moderne të qeverisjes vendore?”
2. Sa të gatshëm jeni të ndani praktika të mira ose të përfshiheni në pilotime apo grupe pune që lidhen me tematikat ku bashkia juaj ka nevojë të forcohet?”

Përgjigje

1. Të gjitha janë të rëndësishme. Bashkia nuk ka patur një program të brendshëm financimi për trajnimet e stafit, por kemi përfituar nëpërmjet trajnimeve që janë përfituar nga palë të treta sic mund të jetë Shoqata e Bashkive apo Bashkitë e Forta.

Vijueshmëria e programeve të trajnimit për fusha specifike duhet të jetë shumë e rëndësishme psh në sektorë të caktuar të tilla si planifikimi urban, transporti i qëndrueshëm, shërbimet sociale të qëndrueshme apo projektet me BE. Nga ana tjetër është shumë e nevojshme një ndërveprim me bashkitë tona, të cilat mund të kenë eksperiencë të ngjashme për çështje të caktuara psh. Nëse një bashki jep një rekomandim në një fushë të caktuar si çështje që lidhen me transportin në qytetin e tyre, menaxhimin e sinjalistikës, trafikut rrugor etj. Pra e rëndësishme është komunikimi me bashki të ngjashme për nga numri i popullatës apo menaxhimit të territorit. Forma të tjera të trajnimit apo bashkëpunimit vendor i mirëpresim.

2. Jemi të gatshëm nëse kërkohet ekspertiza jonë mbi programet që kemi zbatuar me qëllimin e ndarjes së njohurive me bashkitë e tjera.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin me ju dhe jemi të gatshëm nëse kërkohet përsëri komunikim.

3. Bashkia POGRADEC

Intervistuesi: Evis Gjebrea, ekspert për Vlerësimin e Nevojave për Trajnime

Facilituesi: Elisa Nikaj, Koordinator projektsh pranë Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë

I intervistuari: Zj. Entela Gusho / N/Kryetar i Bashkisë Pogradec

Data: 18 Mars, 2026

A) Pyetje për të konfirmuar gjetjet (5–10 minuta)

Nga temat e listuara si prioritare (projekte BE; roli në integrim & zbatimin e reformave; monitorimi me indikatorë), cilat dy janë realisht më kritike sot për bashkinë tuaj? Pse?

Grupet ku duhet fokusuar: A vijojnë specialistët teknikë dhe drejtuesit e mesëm të jenë grupet që kanë hendekun më të madh të aftësive? Në cilat detyra specifike?

Përgjigje

Të gjitha gjetjet janë me vend dhe nuk mund të ndahen sepse plotësojnë njëra tjetrën.

Specialistët kanë hendekun më të madh sepse puna më e madhe zbatohet nga specialistët sesa nga përgjegjësit apo drejtorët. Zbatueshmëria e projekteve, problematikat apo terreni lidhen me punën drejtpërdrejt të specialistëve. Në këto kushte barra më e madhe bie mbi ta.

B) Pyetje për temat me interes të lartë (20–25 minuta)

1. Në cilat procese të administrimit vendor (p.sh., planifikim, raportim, standardizim procedurash, menaxhim të të dhënave) e shihni më të mundshëm kontributin konkret të bashkisë suaj në procesin e integritimit në BE, dhe cilat kapacitete shtesë ju nevojiten për t'i përmbushur këto kërkesa në përputhje me praktikën europiane ?

2. Planifikimi territorial është kthyer në një çështje të rëndësishme për Bashkitë. “Cilat kapacitete teknike dhe institucionale i mungojnë bashkisë suaj për të kryer në mënyrë të efektshme procesin e planifikimit territorial—përfshirë analizën hapësinore, menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore, interpretimin e legjislativitetit dhe koordinimin me aktorë të tjerë—dhe çfarë mbështetjeje do t'ju duhej për t'i forcuar këto kapacitete në praktikë ?

Përgjigje

1. Nuk mund të ndahen mendohet që janë pjesë përbërëse sepse janë të rëndësishme.

2. Në drejtim të planifikimit territorial ka nevojë për të gjitha aspektet e përmendura sepse edhe ndryshimet territoriale apo mungesa e dokumentacionit janë mjaft të rëndësishme. Bashkia Pogradec ka problematikat në drejtim të këtyre aspekteve dhe gjetjet e pyetësorëve janë me vend dhe duhet të përmirësohen.

ASIG duhet të jetë në avangard për problematikat pasi të dhënat jo gjithmonë janë të azhornuara.

C) Pyetje për qëndrueshmërinë e rritjes së kapaciteteve të Bashkive (10–15 minuta)

1. Cilat mekanizma ose modele zhvillimi (p.sh., programe të qëndrueshme trajnimi, sisteme të brendshme të menaxhimit të njohurive, rrjete ndërbashkiake të të mësuarit apo asistencë teknike e vazhdueshme) mendoni se duhet të ndërtojë bashkia juaj në vitet e ardhshme për të siguruar rritje të qëndrueshme të kapaciteteve dhe për të përmbushur standardet moderne të qeverisjes vendore?”
2. Sa të gatshëm jeni të ndani praktika të mira ose të përfshiheni në pilotime apo grupe pune që lidhen me tematikat ku bashkia juaj ka nevojë të forcohet ?

Përgjigje

1. Nga të gjitha pikat e sugjeruara jam dakord. Ka patur eksperiencë me Bashkitë kufitare psh Bashkia Cërrik, Divjakë (në aspektin social) Struga, Ohri dhe janë të domosdoshme. Sugjerohet bashkëpunim me Bashkitë e Qarkut pasi problematikat janë të njëjta. Problemet sociale arsimore janë të njëjta dhe do sugjeroja që trajnimet të realizohen në profile të ndryshme. E rëndësishme të ketë projekte pilot brenda qarkut. Programe trajnimi sipas profileve psh. për problemet sociale, arsimore, po kështu trajnime nga jashtë (asistencë) pasi ka një kapacitet tjetër. Rritja e kapaciteteve duhet të jetë e vazhdueshme, e herëpashershme.

Faleminderit për këtë intervistë ballë për ballë sepse është forma më e mirë për ti sqaruar problematikat sesa në mënyrë zyrtare.

4. Bashkia ELBASAN

Intervistuesi: Evis Gjebrea, ekspert për Vlerësimin e Nevojave për Trajnime të Bashkive të Shqipërisë.

Facilituesi: Elisa Nikaj, Koordinator projektsh pranë Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë

I intervistuari: Z. Asim Sula / N/Kryetar i Bashkisë Elbasan

Data: 18 Mars, 2026

A) Pyetje për të konfirmuar gjetjet (5–10 minuta)

Nga temat e listuara si prioritare (projekte BE; roli në integrim & zbatimin e reformave; monitorimi me indikatorë), cilat dy janë realisht më kritike sot për bashkinë tuaj? Pse?

Grupet ku duhet fokusuar: A vijojnë specialistët teknikë dhe drejtuesit e mesëm të jenë grupet që kanë hendekun më të madh të aftësive? Në cilat detyra specifike?

Përgjigje

1. Gjetjet përputhen me përparësitë që Bashkia ka. Të gjitha bashkitë kanë nevojë për përmirësim kapacitetesh dhe për trajnime. Janë gjetjet e duhura. Janë të nevojshme trajnime për menaxhimin e projekteve të BE në shkrimin dhe zbatimin e tyre që kanë specifikat e veta. Ekziston zyra e integritimit europian ku është edhe sektori i projekteve, por psh nëse Drejtoria e Mjedisit shkruajnë projekte nuk kanë kapacitete. Të marrësh fonde nga Bashkimi Europian është një dobi e madhe edhe për komunitetin dhe shpeshherë ka problematika në mungesë të kapaciteteve.

2. Rritja e kapaciteteve mund të kalojë edhe te niveli i Drejtorit. Nëse do të flasim për dixhitalizimin e shërbimeve duhet të përfshihet edhe në nivel drejtori ndonëse janë pozicione të ndryshueshme.

B) Pyetje për temat me interes të lartë (20–25 minuta)

1. Në cilat procese të administrimit vendor (p.sh., planifikim, raportim, standardizim procedurash, menaxhim të të dhënave) e shihni më të mundshëm kontributin konkret të bashkisë suaj në procesin e integritimit në BE, dhe cilat kapacitete shtesë ju nevojiten për t'i përmbushur këto kërkesa në përputhje me praktikën europiane?

2. Planifikimi territorial është kthyer në një çështje të rëndësishme për Bashkitë. “Cilat kapacitete teknike dhe institucionale i mungojnë bashkisë suaj për të kryer në mënyrë të efektshme procesin e planifikimit territorial—përfshirë analizën hapësinore, menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore, interpretimin e legjislativitetit dhe koordinimin me aktorë të tjerë—dhe çfarë mbështetjeje do t'ju duhej për t'i forcuar këto kapacitete në praktikë?”

Përgjigje

1. Janë të gjitha të rëndësishme, por te aspekti i menaxhimit ka më tepër problematika.
2. Të gjitha janë të rëndësishme. Kemi bashkëpunim me ASIG dhe është e nevojshme që të kemi kapacitete të brendshme në këtë aspekt.

C) Pyetje për qëndrueshmërinë e rritjes së kapacitetve të Bashkive (10–15 minuta)

1. Cilat mekanizma ose modele zhvillimi (p.sh., programe të qëndrueshme trajnimi, sisteme të brendshme të menaxhimit të njohurive, rrjete ndërbashkiake të të mësuarit apo asistencë teknike e vazhdueshme) mendoni se duhet të ndërtojë bashkia juaj në vitet e ardhshme për të siguruar rritje të qëndrueshme të kapaciteteve dhe për të përmbushur standardet moderne të qeverisjes vendore?”
2. Sa të gatshëm jeni të ndani praktika të mira ose të përfshiheni në pilotime apo grupe pune që lidhen me tematikat ku bashkia juaj ka nevojë të forcohet?”

Përgjigje

1. Ka kalime të njohurive nga një punonjës të tjetri dhe po ashtu bashkëpunime ndërmjet bashkive, por nuk është e qëndrueshme prandaj duhen programe të qëndrueshme trajnimi pasi ndodh që trajnohen punonjësit dhe më pas nuk janë më staf i bashkisë.

Duhet parë edhe mundësia financiare që të kërkohen gjëra që janë të realizueshme dhe po ashtu edhe punonjësit duhet të kenë qëndrueshmëri. Po kështu është e rëndësishme binjakëzimet me Bashki të vendeve të BE-së. Ndarja e eksperiencave ndërmjet bashkive është i domosdoshëm, por nuk mund të konsiderohet i qëndrueshëm. Për të arritur standartet e BE-së për mënyrën sesi funksionojnë e rëndësishme të ketë binjakëzime me bashki si motra në BE në drejtim të zbatimit të legjislacionit në pushtetin vendor sepse ka të njëjtën qasje për tu përfruar me standartet e BE-së. Këtë shoh si pjesën më të rëndësishme.

2. Jemi të gatshëm ashtu si u trajtua në pikën 1.

5. Bashkia VLORË

Intervistuesi: Evis Gjebrea, ekspert për Vlerësimin e Nevojave për Trajnime

Facilituesi: Elisa Nikaj, Koordinator projektsh pranë Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë

I intervistuari: Zj. Vilma Toshkallari / N/Kryetar i Bashkisë Vlorë

Data: 18 Mars, 2026

A) Pyetje për të konfirmuar gjetjet (5–10 minuta)

Nga temat e listuara si prioritare (projekte BE; roli në integrim & zbatimin e reformave; monitorimi me indikatorë), cilat dy janë realisht më kritike sot për bashkinë tuaj? Pse?

Grupet ku duhet fokusuar: A vijojnë specialistët teknikë dhe drejtuesit e mesëm të jenë grupet që kanë hendekun më të madh të aftësive? Në cilat detyra specifike?

Përgjigje

1. Projektet me BE-në janë të rëndësishme dhe në këtë drejtim temat e BE janë në kapitujt që po punohet aktualisht nga ministritë. Ndërsa në bashki ky proces ndihet më pak dhe në këtë drejtim konsiderohet se kanë rol dytësor. Duhet të ndryshojë mendësia sepse edhe punonjësit e Bashkisë mendojnë se këto çështje i përkasin pushtetit qendror dhe po ashtu kalendari i kapitujve duhet të bëhet pjesë e veprimtarisë së pushtetit vendor. Në këto kushte integrimi evropian nga Bashkitë nuk duhet parë si një proces i largët, por si aktorë të drejtpërdrejtë në proces. Psh. Nëse do të pyesim një urbanist për integrimin do ta lidhë me projektet e BE-së dhe jo me parimet apo standartet që duhet të integrohen në punën e përditshme të tyre.

2. Nëse flasim për çështjet e integritit evropian është një çështje holistike që fillon nga specialisti për të vazhduar me përgjegjësit dhe drejtorët. Sigurisht që baza e qëndrueshmërisë në institucion përfshin specialistin dhe përgjegjësin krahasuar me titullarin e institucionit. Nuk duhen përjashtuar as drejtorët apo titullarët.

B) Pyetje për temat me interes të lartë (20–25 minuta)

1. Në cilat procese të administrimit vendor (p.sh., planifikim, raportim, standardizim procedurash, menaxhim të të dhënave) e shihni më të mundshëm kontributin konkret të bashkisë suaj në procesin e integritit në BE, dhe cilat kapacitete shtesë ju nevojiten për t'i përmbushur këto kërkesa në përputhje me praktikën europiane ?

2. Planifikimi territorial është kthyer në një çështje të rëndësishme për Bashkitë. “Cilat kapacitete teknike dhe institucionale i mungojnë bashkisë suaj për të kryer në mënyrë të efektshme procesin e planifikimit territorial—përfshirë analizën hapësinore, menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore, interpretimin e legjislativës dhe koordinimin me aktorë të tjerë—dhe çfarë mbështetjeje do t'ju duhej për t'i forcuar këto kapacitete në praktikë ?

Përgjigje

1. Të gjithë elementët janë të rëndësishëm. Nëpërmjet rolit të NAMA ndihet një ndikim më i madh i bashkive në projekt aktet e pushtetit qendror si VKM, konsultimet në këshillin konsultativ dhe një hap i rëndësishëm është që jo vetëm projekt aktet të diskutohen në këshillin konsultativ, por edhe vendime të tjera, strategji, politika që kanë të bëjnë me BE ndoshta grup kapituajt ku të diskutohen arritjet e herëpashershme. Ndodh që ka arritje në grup kapituajt dhe nuk diskutohen me Bashkitë për të qënë në të njëtin nivel diskursi.

2. Temë shumë sensitive. Kemi patur mbledhjen e komisionit këshillimor për rregulloren e menaxhimit të hapësirave publike pasi ka një unifikim që ndihmon në menaxhimin e përbashkët. Është një hap i mirë pasi nuk do të ketë një plan për rregullimin e hapësirave publike i miratuar nga Këshilli Bashkiak, por një dokument të unifikuar për të gjitha bashkitë.

Bashkitë hasin veështirësi në këtë proces psh për gjetjen e ekspertëve inxhinierëve, arkitektëve pasi niveli i pagave është i ulët dhe zgjedhin tregun privat.

C) Pyetje për qëndrueshmërinë e rritjes së kapacitetve të Bashkive (10–15 minuta)

1. Cilat mekanizma ose modele zhvillimi (p.sh., programe të qëndrueshme trajnimi, sisteme të brendshme të menaxhimit të njohurive, rrjete ndërbashkiake të të mësuarit apo asistencë teknike e vazhdueshme) mendoni se duhet të ndërtojë bashkia juaj në vitet e ardhshme për të siguruar rritje të qëndrueshme të kapaciteteve dhe për të përmbushur standardet moderne të qeverisjes vendore?”

2. Sa të gatshëm jeni të ndani praktika të mira ose të përfshiheni në pilotime apo grupe pune që lidhen me tematikat ku bashkia juaj ka nevojë të forcohet?”

Përgjigje

1. Bashkia Vlorë ka qënë pjesë e projektit Bashki të Forta. Në kuadër të krijimit të Akademisë së Trajnimit për Vetëqeverisjen Vendore Bashkia ka buxhetuar një fond. Ajo që del si nevojë është ngritja e sistemit të përbashkët një platformë kombëtare ku të jenë të publikuara njoftime të ndryshme për trajnime psh. ASPA, NAMA, BE, organizata të ndryshme etj. Trajnimi i brendshëm vjen si nevojë, por është më i vështirë për Bashkitë e mëdha që kanë dinamika pune dhe volum të madh. Psh është e vështirë për inxhinierët për të trajnuar të tjerë, por mund të jetë një instrument i rëndësishëm.

2. Të gjithë bashkitë me njëra tjetrën i ndajnë praktikatat me Bashki të ngjashme. Kur ka projektvendime me bashki bregdetare Durrës, Saranda, Lezha kemi ndarë praktika dhe kemi mësuar për menaxhimin e plazheve publike apo për Vlora Invest apo për pagat e policisë bashkiake janë diskutuar në takimet e përbashkëta të shoqatës së bashkive dhe është një punë e jashtëzakonshme sepse rrjetëzimi, marrëdhëniet dhe kontaktet me të tjerët janë të rëndësishme.

Në përfundim besoj dhe uroj që në të ardhmen Roli i Bashkive në procesin e BE-së të jetë shumë herë më i lartë dhe të mos mbetet si çështjet e vetëm një strukture zyra e kordinimit me BE-në.

Standartet të përkthehen në hapa konkretë. Kapitujt duhet të përkthehen në veprimtari të drejtpërdrejtë. Psh nëse ka një kapitull për çështje të bujqësisë të mblidhen palët të ndajnë detyrat konkrete.

Referencat

Albanian Municipalities in 2035: Three Scenarios for the Future. Tiranë, 2025.

DRAFT Strategic Plan: National Association of Municipalities of Albania (2026–2030). Version 1.1, Tiranë, 2025.

European Commission, Albania 2024 Report, page 24,
https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

PESTLE Analysis for Albania's Local Governments (2025–2030), page 9.

Përmbledhje e Strategjisë 2026–2030. Tiranë, 2025.

Survey Data Analysis and Reporting: Voice of the Municipalities. Tiranë, 2025.